

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

**GJYQTARE: REXHINA MERLIKA**

Asistuar prej sekretares gjyqësore Manjola Islamaj, në Tiranë, sot më datë 25.06.2015, mori në shqyrtim materialin procedues me Nr..... Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Armand Gurakuqi.

**OBJEKTI:**

- Sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike në pronësi, posedim, apo administrim të shtetasit E. V. ose familjarëve të tij.
- Të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si email, Chat, sms dhe cdo komunikim nëpërmjet programeve kompjuterike të tjera, në të cilat përmbahen të dhëna mbi materiale pornografike me të mitur dhe çdo e dhënë tjetër e dobishme për hetimin.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 208/a të K.Pr.Penale

Gjykata pasi u njoh me materialet e çështjes, dëgjoi Prokurorin, i cili kërkoi: -Sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike në pronësi, posedim, apo administrim të shtetasit E. V. ose familjarëve të tij. -Të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si email, Chat, sms dhe cdo komunikim nëpërmjet programeve kompjuterike të tjera, në të cilat përmbahen të dhëna mbi materiale pornografike me të mitur dhe çdo e dhënë tjetër e dobishme për hetimin.

**VËREN**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë me datë 11.06.2015, ka regjistruar procedimin penal Nr..... të referuar për kryerjen e veprës penale “Pornografia”, parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal.

Nga Interpol Wiesbaden, Sektori për Krimin Kompjuterik ka marrë një informacion në lidhje me shpërndarjen në rrjet të materialeve pornografike me të mitur nëpërmjet rrjetit eDonkey2000.

Në këtë informacion ndërmjet të tjerash thuhet se mes datave 12 Janar 2015 dhe 27 Mars 2015, Zyra Kriminale e policisë së shtetit Baden Ëurttemberg, ka kryer kërkime të rastësishme në rrjetin eDonkey për pornografi me të mitur.

Kërkimet kanë treguar se klientë të ndryshëm kanë ofruar 100% kopje të materialit të kërkuar në rrjetin eDonkey, i cili gjithashtu është ruajtur dhe nga Zyra Kriminale e Policisë së Shtetit Baden Wurttemberg. Materiali përmbante video pornografike me fëmijë duke treguar abuzimin seksual ndaj disa fëmijëve dhe më saktësisht një vajzë që prezumohet e moshës 4 vjeç, një djalë që prezumohet i moshës 7 vjeç, një vajzë që prezumohet e moshës 8 vjeç. Autorët dhe viktimat janë identifikuar në vitin 2011. Zyra kriminale ka zhvilluar kërkime për materialin e mëposhtëm për pornografi me të mitur filehash (eDonkey2000 Hash): 308c9e3650ec52ec9049bc1bc4108b1f. Me këtë material hash ka filluar kërkimi në rrjetin eDonkey2000.

Emri i materialit mund të jetë i ndryshëm në oferta të veçanta por kjo nuk është thelbësore duke qenë se “filehash” dhe pjesa përbërëse e këtij materiali është gjithmonë e njëjtë. Bashkëlidhur janë dhe listat emrave të materialeve që nuk përmbushin kriteret. Gjithashtu dhe lista që tregon se cili përdorues (userhash) ka shkarkuar materialin (filehash) me cilin emër materiali dhe në cilën datë.

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion për kërkimet e kryera rezulton se:Nga Shqipëria më datë 01.04.2015 ora 13:21:35 UTC është gjeneruar raporti me Nr. 385, për përdoruesin (userhash) me kodin .....61.....851.....6..., i cili nga IP .....22.7, datë 30.01.2015 00:08:26 UTC ka disponuar materialin (filehash) .....65.....04.....10.....

Nga verifikimet paraprake ka rezultuar se kjo IP (Internet Protocol) i përket subjektit A...N...

Gjithashtu nga Interpoli Ëiesbaden është vënë në dispozicion dhe video me materialin pornografik me të mitur, një tabelë fotografike mbi këtë video si dhe materiale të tjera në lidhje me kërkimin dhe dokumentimin e provës së gjetur në rrjetin eDonkey2000.

Në këto kushte, ne rastin konkret nga organi i akuzës është çmuar se ekzistojnë kushtet e nenit 208/a të K.Pr.Penale, për sekuestrimin e të dhënave e sistemeve kompjuterike si dhe për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhëna kompjuterike që lidhen me veprën penale objekt hetimi. Këto të dhëna e sisteme mund të jenë në pronësi, posedim, apo administrim të shtetasit E. V., me adresë rruga “M.....”, të cilat përbëjnë prova për veprën penale objekt hetimi. Pikërisht për të mundësuar sekuestrimin e sendeve të mësipërme është e nevojshme që të kryhet kontrolli i shtetasit E. V. dhe banesës së këtij personi me adresë rruga “M.....”, Tiranë.

Gjykata pasi shqyrtoi materialin procedues lidhur me kërkesën e prokurorit konstaton se ajo është e bazuar në nenet 208 e 208/a të K.Pr.Penale.

Dispozitat referuese parashikojnë konkretisht:

Neni 208 “Objekti i sekuestrimit”

*“1.Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.*

*2.Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.*

*3.Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm”.*

Ndërsa Neni 208/a “Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike” (Shtuar me ligjin nr.10 054, datë 29.12.2008):

*“ 1. Në rastin e procedimeve për veprat penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos sekuestrimin e të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim, gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik.*

*2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik.*

*3. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa: a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash; b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike; c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje; ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.*

*4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme”.*

Sipas dispozitave të mësipërme gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Në rastin konkret bëhet fjalë për një procedim penal të nisur për veprën penale të “Pornografisë” parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal, pra ndodhemi para një vepre penale si dhe ka të dhëna të bazuara se këto prova materiale që kërkohen të sekuestrohen mund të jenë në pronësi, posedim apo admintrim të shtetasit E.. V. ose familjarëve të tij sipas (proces verbal “ Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 07.06.2015; shkresë Nr..... datë 12.06.20150, të dhëna nga Byroja kriminale e Landit Baden Wurttemberg.).

Sa më sipër gjykata bazuar në nenet 208 e 208/a të K.Pr.Penale çmon në pranimin e kërkesës për sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike në pronësi, posedim, apo administrim të shtetasit E. V. ose familjarëve të tij si dhe të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si email, Chat, sms dhe cdo komunikim nëpërmjet programeve kompjuterike të tjera, në të cilat përmbahen të dhëna mbi materiale pornografike me të mitur dhe çdo e dhënë tjetër e dobishme për hetimin.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenet 208 e 208/a të Kodit të Procedurës Penale

### **V E N D O S I**

-Sekuestrimin e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike në pronësi, posedim, apo administrim të shtetasit E. V. ose familjarëve të tij.

-Të lejohet hyrja, kërkimi dhe marrja e të dhënave kompjuterike në sistemet kompjuterike objekt sekuestrimi, duke përfshirë, ndër të tjera, komunikimet elektronike si email, Chat, sms dhe cdo komunikim nëpërmjet programeve kompjuterike të tjera, në të cilat përmbahen të dhëna mbi materiale pornografike me të mitur dhe çdo e dhënë tjetër e dobishme për hetimin.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

-U shpall sot, në Tiranë me dt. 25.06.2015.

**S E K R E T A R E**

**G J Y Q T A R E**

**MANJOLA ISLAMAJ**

**REXHINA MERLIKA**